



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORE

Nr.Regj. Them 514

Data e ardhjes 20.12.2011

Nr.514 Vendimi
Data 22.12.2011

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORE, E PERBERE PREJ :

HERILA ÇELA – GJYQTARE

Asistuar prej sekretares gjyqesore **Xhuljeta Dinaj**, sot me date 22.12.2010, perfundoi ne seance gjyqesore me dyer te hapura, ceshtjen penale Nr.514 date 20.12.2011, qe i perket

KERKUES :

Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Vlore, perfaqesuar nga prokurorja [REDACTED]

OBJEKTI :

Caktimin si masë të sigurimit pasuror atë të sekuestros preventive për pasuritë takuese në natyrë të palës pronare [REDACTED] të ndodhura në lagjen “Pavarësia”, Vlorë, në ndërtimin shumëkatësh me palë investitore [REDACTED] sh.p.k., si më poshtë vijon:

- Apartament kati katërt banim, nr. 1, tip (1+1), me sipërfaqe 61 m2 (gjashtëdhjetë e një) sipërfaqe neto, sipas planimetrisë bashkëngjitur me nr. 4/A1
- Apartament kati shtatë banim, nr. 6, tip (1+1), me sipërfaqe 61 m2 (gjashtëdhjetë e një), sipërfaqe neto sipas planimetrisë bashkëngjitur me nr. 7/A6.
- Apartament kati tretë banim, nr. 6, tip (1+1) me sipërfaqe 61 m2 (gjashtëdhjetë e një), sipërfaqe neto sipas planimetrisë, bashkëngjitur me nr. 8/A6.
- Apartament kati tretë banim nr. 2, tip (2+1), me sipërfaqe 94 m2 (nëntëdhjetë e katër), sipërfaqe neto sipas planimetrisë bashkëngjitur me nr. 3/A2.
- Apartament kati tretë banim nr. 3, tip (2+1) me sipërfaqe 87 m2 (tetëdhjetë e shtatë) sipërfaqe neto sipas planimetrisë bashkëngjitur me nr. 3/A3
- Apartament kati tretë banim nr. 6, tip (1+1) me sipërfaqe 61 m2 (gjashtëdhjetë e një) sipërfaqe neto sipas planimetrisë bashkëngjitur me nr 3/A6
- Njësi shërbimi me sipërfaqe 62 m2 (gjashtëdhjetë e dy), i ndodhur në katin e parë nga niveli zero, me fasadë orientuese veri-jug, me nr. 6/1 dhe nr. 7/1, pjesën

takuese të këtij bashkëpronari kontata nr. 3988 Rep. datë 1970 Kol. datë 14.12.2009)

Njësi shërbimi me sipërfaqe 137 (njëqind e tridhjetë e shtatë) m2, i ndodhur në katin e dytë nga niveli zero, me orientim veri-perëndim 12,13,14

BAZA LIGJORE: Nenin 274 paragrafi 1 dhe 2, të K.Pr.Penale

Gjykata, në perfundim të shqyrtimit gjyqësor:

Pasi degjoi organin e akuzes Prokurorine e Rrethit Gjyqësor Vlorë të perfaqësuar prej Prokurorja e çështjes [REDAKTUAR] cila kerkoi:

Pranimin e kesaj kerkese si te pabazuar ne ligj dhe ne prova,

dhe pasi çmoi dhe vleresoi provat e marra ne seance gjyqësore;

VEREN

Prokuroria pranë gjykatës së rrethit gjyqësor Vlorë, mbi bazën e materialit të referuar nga policia Gjyqësore me shkresën nr. 8485, datë 04.10.2011, ka regjistruar procedimin penal nr. 1260, datë 05.10.2011, për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale", trashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

nga studimi i të dhënave të dokumentuara gjatë hetimeve paraprake, zulton se:

ana e policisë gjyqësore, ka të dhëna se shtetasi [REDAKTUAR] lindur më 07.1958, në Vlorë dhe banues në Vlorë, duke përdorur dokumenta të fallsifikuara ka regjistruar pranë Z.R.V.P.P-Vlorë, një sip. prej 1050 m2 truall, në lagjen "Pavarsia", nr. Kjo sipërfaqe është rregjistruar pranë Z.R.V.P.P.Vlorë, më dt.11.04.2007, në nr.8602, nr.pasurie 29/524, vol.32, fq.28 dhe është rregjistruar në bazë të Vendimit të K.Pronave, Tiranë.

regjistrimin e kësaj sipërfaqe trualli, shtetasi [REDAKTUAR] ka përdorur vendimin nr. 0/66, dt.30.04.1947, të Komitetit Ekzekutiv të Nënprefekturës, Vlorë. Prokuroria e gjykatës së rrethit gjyqësor Vlorë, në lidhje me këto fakte, ka regjistruar procedimin penal me nr.854, të vitit 2008, me të pandehur [REDAKTUAR] akuzuar për veprën penale "Fallsifikim i dokumentave", parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Me vendimin nr.296, dt.28.07.2009, Gjykata e rrethit gjyqësor Vlorë ka vendosur deklarimin "afajshëm" të të pandehurit [REDAKTUAR] për veprën penale "Fallsifikim i dokumentave", parashikuar nga neni 186 i K.Penal, ndërsa nga ana tjetër Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.566, dt.19.11.2009, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së rrethit gjyqësor Vlorë dhe deklarimin fajtor të pandehurit [REDAKTUAR] për këtë veprë penale. Më tej, nga administrimi i dokumentacionit përkatës ka rezultuar se me Vendimin nr. 4/26, dt.14.12.2007, pronarit të kësaj sipërfaqe trualli, Gëzim Braza, i është miratuar destinacioni për shesh.

Nga K.Rr.T. Bashkia Vlorë, me vendimin nr.2/72, dt.06.05.2008, subjektit ndërtues shoqëria [redacted] është miratuar leja e ndërtimit për objekt banesë 2-8-9- KT, me pronar truall shtetasin [redacted] në lagjen "Pavarsia", Vlorë.

Nga dokumentacioni i regjistruar rezulton se më dt.19.04.2007, është nënshkruar një kontratë sipërmarrje midis shoqërisë ndërtuese [redacted] sh.p.k. dhe me cilësinë e palës pronar truall [redacted] ku në sipërfaqen prej 1050 m2, me pronar truall [redacted] do të ndertohet apartament banimi. Në këtë kontratë rezulton se pala pronar truall do të përfitojë 21% të sipërfaqes ndërtimore të objektit, ku në këtë kontratë janë të përcaktuara pasuritë që do të përfitojë pala pronare e truallit, në përfundim të objektit.

Për sa më sipër, rezulton se ka të dhëna të mjaftueshme për të vlerësuar se ndodhemi përpara elementëve të veprës penale " Pastrim i produkteve të veprës penale", parashikuar nga neni 287 K.Penal, në ngarkim të shtetasit [redacted] dhe mbi këtë bazë, më datë 05.10.2011, është regjistruar edhe procedimi penal.

Dokumentacioni i përdorur nga shtetasi [redacted] për regjistrimin e kësaj pasurie rezulton i falsifikuar, referuar edhe vendimit të Gjykatës së Apelit, Vlorë nr. [redacted] dt. [redacted]. Kjo pasuri, duke ditur se është përfituar në mënyrë të paligjshme dhe me dokumenta të falsifikuara, është përdorur më pas me destinacion shesh ndërtimi, me qëllim ndërtimin e një apartamenti 8-9 katesh në lagjen "Pavarsia", Vlorë, ku pala pronar truall ka përfituar pronësi në këtë apartament, në bazë të kontratës së sipërmarrjes dt.19.04.2007, nr.2350 rep dhe 1309 kol. Konkretisht, sipas kësaj kontrate sipërmarrje pala pronare e truallit që në kë rast është personi nën hetim [redacted] ka përfituar si më poshtë vijon:

1. Apartament kati katërt banim, nr. 1, tip (1+1), me sipërfaqe 61 m2 (gjashtëdhjetë e një) sipërfaqe neto, sipas planimetrisë bashkëngjitur me nr. 4/A1
2. Apartament kati shtatë banim, nr. 6, tip (1+1), me sipërfaqe 61 m2 (gjashtëdhjetë e një), sipërfaqe neto sipas planimetrisë bashkëngjitur me nr. 7/A6.
3. Apartament kati tretë banim, nr. 6, tip (1+1) me sipërfaqe 61 m2 (gjashtëdhjetë e një), sipërfaqe neto sipas planimetrisë, bashkëngjitur me nr. 8/A6.
4. Apartament kati tretë banim nr. 2, tip (2+1), me sipërfaqe 94 m2 (nëntëdhjetë e katër), sipërfaqe neto sipas planimetrisë bashkëngjitur me nr. 3/A2.
5. Apartament kati tretë banim nr. 3, tip (2+1) me sipërfaqe 87 m2 (tetëdhjetë e shtatë) sipërfaqe neto sipas planimetrisë bashkëngjitur me nr. 3/A3
6. Apartament kati tretë banim nr. 6, tip (1+1) me sipërfaqe 61 m2 (gjashtëdhjetë e një) sipërfaqe neto sipas planimetrisë bashkëngjitur me nr 3/A6

Dhe njësi shërbimi (dyqane)

1. Njësi shërbimi me sipërfaqe 62 m2 (gjashtëdhjetë e dy), i ndodhur në katin e parë nga niveli zero, me fasadë orientuese veri-jug, me nr. 6/1 dhe nr. 7/1.
2. Njësi shërbimi me sipërfaqe 137 (njëqind e tridhjetë e shtatë) m2, i ndodhur në katin e dytë nga niveli zero, me orientim veri-perëndim 12,13,14

Në këto kushte, duke qënë se pronësia mbi truallin me sipërfaqe 1050 m2, regjistruar në Z.R.P.P. është produkt i veprës penale të "Falsifikimit të dokumentave", parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, për të cilën ky person është deklaruar nga gjykata fajtor me vendim të formës së prerë, edhe apartamentet e banimit apo njësitë e shërbimit të

përfituara prej kontratës së sipërmarrjes janë rrjedhojë e saj. Këtë pasuri, personi nën hetim, e ka përfitur pikërisht në sajë të falsifikimit të dokumentave dhe është pasuri e cila lidhet drejtpërdrejt me të, disponimi i lirë i së cilës ka rrezik të zgjasë më tej pasojat e veprës penale.

Për sa më sipër, duke qenë se bëhet fjalë për pasuri që dyshohet se rrjedh ose është fituar nga kryerja e veprave penale dhe se duke patur parasysh se disponimi i lirë i kësaj pasurie lidhet me veprën penale për të cilat hetohet, rëndon ose zgjat pasojat e saj, ekzistojnë kushtet dhe kriteret ligjore, të parashikuara nga neni 274 i K.Pr.Penale, që ndaj pjesës së pasurisë që i përket personit nën hetim, sipas kontratës së sipërmarrjes, të caktohet një masë e sigurimit pasuror, si është ajo e sekuestros preventive.

Neni 274 i K.Pr.Penale shprehimisht citon si me poshte:

1. Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar.
2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e vepres penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal
3. Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata, me kërkesën e prokurorit ose të interesuarit, e heq sekuestron.

rethanat e faktit të pretenduara në vendimin e sekuestros, natyra e sendeve të kuestruara vertetojnë në mënyrë të padyshimte lidhjen e sendeve të sekuestruara me veprën penale.

PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar në nenin 274 të Kodit të Procedres Penale:

VENDOSI

Vendimi i kërkesës së kerkuesit Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë me objekt : Caktimin e masës së sigurimit pasuror atë të sekuestros preventive për pasuritë takuese në natyrë të pronare të ndodhura në lagjen "Pavarësia", Vlorë në ndërtimin e katësh me pale investitore sh.p.k., si më poshtë vijon:

Apartament kati katërt banim, nr. 1, tip (1+1), me sipërfaqe 61 m2 (gjashtëdhjetë e një) sipërfaqe neto, sipas planimetrisë bashkëngjitur me nr. 4/A1

Apartament kati shtatë banim, nr. 6, tip (1+1), me sipërfaqe 61 m2 (gjashtëdhjetë e një), sipërfaqe neto sipas planimetrisë bashkëngjitur me nr. 7/A6.

Apartament kati tretë banim, nr. 6, tip (1+1) me sipërfaqe 61 m2 (gjashtëdhjetë e një), sipërfaqe neto sipas planimetrisë, bashkëngjitur me nr. 8/A6.


Apartament kati tretë banim nr. 2, tip (2+1), me sipërfaqe 94 m2 (nëntëdhjetë e katër), sipërfaqe neto sipas planimetrisë bashkëngjitur me nr. 3/A2.

- Apartament kati tretë banim nr. 3, tip (2+1) me sipërfaqe 87 m2 (tetëdhjetë e shtatë) sipërfaqe neto sipas planimetrisë bashkëngjitur me nr. 3/A3
- Apartament kati tretë banim nr. 6, tip (1+1) me sipërfaqe 61 m2 (gjashtëdhjetë e një) sipërfaqe neto sipas planimetrisë bashkëngjitur me nr. 3/A6
- Njësi shërbimi me sipërfaqe 62 m2 (gjashtëdhjetë e dy), i ndodhur në katin e parë nga niveli zero, me fasadë orientuese veri-jug, me nr. 6/1 dhe nr. 7/1, pjesën takuese të këtij bashkëpronari. (kontata nr. 3988 Rep., datë 1970 Kol, datë 14.12.2009)
- Njësi shërbimi me sipërfaqe 137 (njëqind e tridhjetë e shtatë) m2, i ndodhur në katin e dytë nga niveli zero, me orientim veri-perëndim 12,13,14

Kunder këtij vendimi lejohet ankim brenda afateve ligjore ne Gjykatën e Apelit Vlore.

U shpall ne Vlore me date 22.12.2011

SEKRETARE
XHULJETA DINAJ



GJYQTARE
HERILA ÇELA



-Vendimi mori formë të prerë me vendimin Nr. 26 date 08.02.2012, te Gjykatës se Apelit Vlore e cila ka vendosur:

-Miratimin e vendimit nr. 514 date 22.12.2011 te Gjykatës se Shkalles se Pare Vlore

KANCELARE
IRMA DHIMITRIADHI

